



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosovo</b> <b>Republic of Kosovo</b> <b>KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS</b> <b>SUDSKI SAVET KOSOVA</b> <b>KOSOVO JUDICIAL COUNCIL</b>	
<b>Nr.Br.No.</b>	01 / 255	
<b>DAT.DT.</b>	28.04.21	
	<b>PRISHTINË - A</b>	

KGJK. Nr. 74/2021

Datë: 24 mars 2021

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Bekim Avdimetaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega ne Deçan, dhe Sulltan Dobraj, Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Deçan, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/30/2020/GJTHPE-AD/GJTHPE/09/20, të datës 27 korrik 2020, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 24 mars 2021, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**Hudhet poshtë** raporti hetimor me numër Nr.AD/KGJK/30/2020/GJTHPE-AD/GJTHPE/09/20, të datës 27 korrik 2020, dhe pushon procedura disiplinore ndaj gjyqtarit te Gjykatës Themelore në Pejë dega në Deçan Bekim Avdimetaj për shkak të parashkrimit absolut të shkeljes disiplinore, kurse ndaj gjyqtarit Mbikëqyrës Sulltan Dobraj për shkak se pretendimi i supozuar ndaj tij nuk përbën shkelje disiplinore.

## A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër Nr.AD/KGJK/30/2020/GJTHPE-AD/GJTHPE/09/20, të datës 27 Korrik 2020, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljet disiplinore të pretenduara të Gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Deçan Bekim Avdimetaj, të përcaktuara nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës të të njëjtës degë Sulltan Dobraj, për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.13 të lartë cekur.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës për ta shqyrtuar këtë çështje me datë 21 dhjetor 2020 dhe 24 mars 2021 ka mbajtur seancat dëgjimore, ku janë dëgjuar palët në procedurë dhe është bërë edhe administrimi i provave. Mirëpo KGJK duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar se në rastin konkret ka ardhur deri të parashkrimi absolut i shkeljeve disiplinore të pretenduara për të dy subjektet e këtij hetimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti i parë i hetimit Gjyqtari Avdimetaj pretendohet se ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës të sanksionuara me nenin 5, paragrafi 2, pika 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe se qe nga ajo kohë e deri

me fillimin e hetimit disiplinor për të kanë kaluar me tepër se dy (2) vite, ndërsa Ligji Nr.05/L-003 për Plotësim Ndryshim të Ligjit Nr.03/L-223, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës me nenin 15, paragrafi 1 (5), është paraparë se procedura disiplinore nuk mund të filloj dhe të zhvillohet në Komisionin Disiplinor pasi të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor për shkeljen e supozuar dhe dy(2) vite nga dita e shkeljes së supozuar.

Pra në rastin konkret parashkrimi i shkeljes së supozuar disiplinore për gjyqtari Avdimetaj ka arritur parashkrimin me 22.05.2020.

Ndërsa për subjektin e dytë të hetimit gjyqtarin Mbikëqyrës Sulltan Dobraj i cili pretendohet se ka bërë shkelje disiplinore të sanksionuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.13, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve duke mos e njoftuar Kryetarin e Gjykatës Themelore në Pejë për shkeljen e supozuar të gjyqtari Avdimetaj Këshilli vlerësoj se i njëjti nuk ka bërë shkeljen e supozuar pasi vlerësoj se në kohën kur po pretendohet që i njëjti është dashur ta kryej këtë njoftim ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë nuk ka qenë në fuqi Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve i cili ligj me nenin 9, parasheh një obligim të tillë për gjyqtarin Mbikëqyrës. Dhe duke pasqyruar parimin e legalitetit Këshilli vlerësoj se i njëjti nuk mund të vije para përgjegjësisë disiplinore për një shkelje e cila me ligj nuk ka qenë e parapare me herët si shkelje disiplinore.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.74/2021, datë: 24 mars 2021**

**Skender ÇOÇAJ,**  
**Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**



**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Armend Berisha, Kryetar, Gjykata Themelore në Pejë;*
- *Bekim Avdimetaj, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Pejë-dega në Deçan;*
- *Sulltan Dobraj, Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan;*
- *Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;*
- *Arkivit.*